



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Studentëve (KQZ)

	Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universiteti Prizrenia UNIVERSITETI PRIZREN
Prandajr i p...	23.06.2023
	Nr. i protokollit 03-268

Rruga e Shkronjave nr.1 20 000 Prizren-Kosovë ; Tel :+383 (0) 29 232 140 ; Homepage :www.uni-prizren.com

nr. ref. _____ Prizren, më : 23/06/2023

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve të Studentëve (KQZ) i formuar sipas vendimit të KD-së nr. 01-366, të datës 16.06.2023, bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" nr. 04-V-621, Rregulloren për zgjedhjet e studentëve nr. 01-34 të datës 09.02.2018, vendimin për plotësim ndryshimin e kësaj rregullore nr. 01-367, të datës 16.06.2023, vendimin për shpalljen e zgjedhjeve të studentëve nr. 01-364, të datës 16.06.2023 si dhe në respektim të dinamikës së zgjedhjeve të miratuar nga Këshilli Drejtues me nr. 01-365, të datës 16.06.2023:

miraton:

Qarkoren administrative të mbarëvajtjes së procesit të zgjedhjeve studentore për vitin 2023

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Studentëve (KQZ) i formuar sipas vendimit të KD-së, nr. 01-366, të datës 16.06.2023, menjëherë pas konstituimit obligohet sipas detyrës zyrtare për publikimin me kohë të të gjitha vendimeve dhe njoftimeve përkatëse në lidhje me zgjedhjet e studentëve.

Faza përgatitore e zgjedhjeve

I

2. **Takimi i parë i KQZ-së** në prezencë të zëvendës Kryesuesit dhe zyrtarit ligjor të KD-së, është realizuar më 20.06.2023.
3. Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendës-kryesuesit. Kryesuesi i KQZ-së, anëtarë ex-officio sipas nenin 12 të rregullores është Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit. Zëvendës-kryesuesi i KQZ-së është zgjedhur përfaqësuesi i Organizatës studentore AS (Alternativa Studentore).
4. KQZ bazuar në dispozitat e rregullores nr. 01-34 cakton edhe personelin teknik – mbështetës në procesin e zgjedhjeve për kryerjen e punëve të Sekretarisë së KQZ-së, procesin e përgatitjes së fletëvotimeve elektronike dhe listave të studentëve me të drejtë vote si dhe punë tjetra deri në ditën e certifikimit të rezultatit zgjedhor. KQZ merr vendim të veçantë për caktimin e stafit teknik - mbështetës për këtë proces.
5. KQZ përmes kryesuesit të KQZ-së kujdeset për zbatimin e dinamikës së zgjedhjeve dhe organizimin e takimeve, procesin e regjistrimit të organizatave studentore dhe respektimin e afateve deri në fazën e dytë që është Certifikimi i Organizatave Studentore.

II

6. Në ditën e parë pas kalimit të afatit të fundit të aplikimit të organizatave studentore, Kryesuesi i KQZ-së, fton takimin e dytë të KQZ-së (23.06.2023) me këtë rend dite:
 - Vlerësimi i procesit të zgjedhjeve deri në këtë fazë.
 - Aprovimi i Qarkores Administrative në përputhje me dinamikën e zgjedhjeve.
 - Llogaritja e kostos buxhetore të procesit të zgjedhjeve dhe hartimi i kërkesës për KD në lidhje me ndarjen buxhetore.
 - Njoftimi nga Kryesuesi për caktimin e stafit teknik mbështetës të KQZ-së.
 - Verifikimi, miratimi dhe shpallja e listës preliminare të studentëve me të drejtë vote.
 - Nxjerrja e njoftimit për afatin e ankesave në lidhje me listën preliminare.
 - Të tjera.

III

7. **Takimi i tretë i KQZ-së organizohet me datën 26.06.2023 me këtë rend dite:**
- Vlerësimi i procesit të zgjedhjeve deri në këtë fazë.
 - Certifikimi i Organizatave Studentore.
 - Tërheqja e shortit për numrat e organizatave pjesëmarrëse.
 - Përgatitja e manualit të votimit në SMU në bashkëpunim me zyrën e IT-së.
 - Njoftimi i përfaqësuesve të organizatave studentore për dorëzimin e listave të Kandidatëve deri më 30.06.2023.
 - Njoftimi i përfaqësuesve të organizatave studentore për hapjen e fushatës zgjedhore më 27.06.2023.
 - Të tjera.

IV

8. **Takimi i katërt i KQZ-së organizohet me datën 03.07.2023 me këtë rend dite:**
- Vlerësimi i procesit paraprak.
 - Shqyrtimi i ankesave në lidhje me listën paraprake dhe shpallja e listës përfundimtare të studentëve me të drejtë vote.
 - Certifikimi i listave të kandidatëve për Parlament të studentëve dhe Këshill të Studentëve.
 - Propozimi i formatit të fletëvotimeve elektronike dhe materialit tjetër zgjedhor, procesverbalit dhe udhëzuesve për zgjedhje.
 - Aprovimi i formatit të fletëvotimeve elektronike dhe materialit tjetër zgjedhor, procesverbalit dhe udhëzuesve për zgjedhje.
 - Të tjera.

V

9. **Takimi i pestë i KQZ-së organizohet me datën 07.06.2023 me këtë rend dite:**
- Vlerësimi i procesit paraprak.
 - Njoftimi i përfaqësuesve të organizatave studentore për mbylljen e fushatës zgjedhore më 07.07.2023, në ora 23:59.
 - Përgatitjet përfundimtare për organizimin e zgjedhjeve të studentëve në mënyrë elektronike përmes SMU-së.
 - Të tjera.

Periudha e votimit (zgjedhjeve)

10. **Data e mbajtjes së zgjedhjeve është 10.07.2023, ditë e Hënë.**
11. **Takimi i KQZ-së në ora 07:00,**
12. **Anëtarët e KQZ-së dhe stafi mbështetës duhet të jenë prezent para hapjes së votimeve dhe të sigurohen që janë marrë të gjitha veprimet e duhura për fillimin e procesit të votimeve online përmes SMU-së.**
13. **Votimi online në SMU hapet në ora 08:00 dhe mbyllet ora 19:00.**
14. **Gjenerimi i rezultateve të votimit nga SMU, bëhet në ora 19:30 dhe të njëjtat pasi të protokolohen shpallen në ueb faqe dhe në hapësirat e Universitetit.**

Periudha pas zgjedhjeve dhe faza për ankesa

15. **Shpallja e rezultateve preliminare më 10.07.2023 dhe njoftimi për afatin e ankesës në KQZ (brenda 72 orëve pasi të jenë shpallur rezultatet preliminare).**
16. **Shpallja e rezultateve përfundimtare 17.07.2023 dhe njoftimi për të afatin e ankesës në shkallën e dytë, respektivisht në Këshillin Drejtues të Universitetit “Ukshin Hoti” (brenda 2 javëve pas shpalljes së rezultateve përfundimtare).**
17. **Certifikimi i zgjedhjeve nga KQZ-ja e studentëve e Universitetit “Ukshin Hoti”.**

Shënim:

Mbledhjet e KQZ-së mund të thirren edhe për çështje të tjera të cilat nuk janë të parapara me këtë qarkore administrative, ashtu siç parashihet me rregulloren për zgjedhjet e studentëve nr. 01-34 të datës 09.02.2018.

Data: 23.06.2023

- Nexhmedin Krasniqi - Kryesues i KQZ-së
- Fatlind Tredhaku - zëvendëskryesues
- Bekim Samadraxha - anëtar
- Nysret Bytyqi - anëtar
- Fatir Rexhaj - anëtar

